

L I G J I P Ë R Q Y T E T I N E S H K U P I T

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Ligj rregullohet: organizimi i Qytetit të Shkupit, si njësi e veçantë e vetadministrimit lokal (në tekstin e mëtejshëm: Qyteti i Shkupit); kompetencat dhe financimi i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit; përdorimi i gjuhëve të bashkësive në Qytetin e Shkupit dhe në komunat në Qytetin e Shkupit; bashkëpunimi ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit; si edhe çështje të tjera me rëndësi për qytetin e Shkupit.

Neni 2

Qytetarët në Qytetin e Shkupit, të drejtën e vetadministrimit lokal e realizojnë përmes formave të deklarimit të drejtpërdrejtë dhe përmes organeve të zgjedhura në mënyrë demokratike të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Neni 3

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët kanë vendbanim të përhershëm në rajonin e Qytetit të Shkupit janë banorë të Qytetit të Shkupit.

Neni 4

Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit kanë cilësinë e personit juridik.

Neni 5

Qyteti i Shkupit ka stemë dhe flamur të cilët përdoren në tërë rajonin e tij.
Komunat në Qytetin e Shkupit kanë stemë dhe flamur të vet, të cilët i përdorin njëkohësisht me stemën dhe flamurin e Qytetit të Shkupit.

Neni 6

Dispozitat e Ligjit për vetadministrim lokal kanë të bëjnë edhe me komunat në Qytetin e Shkupit, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

II. ORGANIZIMI I QYTETIT TË SHKUPIT

Neni 7

Rajonin e Qytetit të Shkupit, e përbëjnë rajonet e komunave Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizarë, në kufijtë e përcaktuar me këtë ligj.

Neni 8

Kufiri i komunës Aerodrom fillon prej urës së vijës hekurudhore në lumin Vardar (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Aerodrom, Qendër dhe Gazi Babë), dhe lëviz përgjatë Qendrës së transportit “Skopje”, nëpër vijën hekurudhore në drejtim të Velesit deri te ura e Markova Rekës, vazhdon nëpër kufirin e jashtëm të KK Lisiçe e Poshtme deri te lumi Vardar, kthen në drejtim të kundërt të rrjedhës së ujit përgjatë lumit Vardar deri në urën e vijës hekurudhore në lumin Vardar (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Aerodrom, Qendër dhe Gazi Babë).

Kufiri i komunës Butel fillon prej gardhit verior të Varrezave të Qytetit “Butel” (pikë takimi i tre kufijve të komunave Butel, Shuto Orizarë dhe Çuçer-Sandevë), dhe lëviz përgjatë rrugës “Brigada Maqedono-Kosovare 10” deri te vija hekurudhore Shkup Veri - Gjorçe Petrov, kthen në perëndim përgjatë vijës hekurudhore deri në rrugën lokale për në fshatin Vizbeg, kthen përgjatë rrugës për në fshatin Vizbeg, vazhdon përgjatë kufirit të jashtëm të KK Vizbeg deri te mbikalimi i hekurudhës me rrugën magjistrale Bllacë-Shkup, kthen në jug përgjatë rrugës magjistrale Bllacë-Shkup deri te udhëkryqi me rrugën e re të planifikuar me Planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit të Shkupit, kthen në lindje përgjatë rrugës deri te udhëkryqi me rrugët “Brigada e Dytë Maqedonase“ dhe “Brigada Maqedono-Kosovare”, vazhdon në lindje përgjatë rrugës “Brigada e Dytë Maqedonase” deri në udhëkryqin me bulevardin “Hristijan Todorovski – Karposh”, kthen përgjatë bulevardit “Hristijan Todorovski – Karposh”, në jug deri te Qendra për deratizim dhe duke i rënë përqark del në kufirin e Park-pyllit “Gazi Babë” (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Butel, Çair dhe Gazi Babë), lëviz përgjatë kufirit perëndimor të Park-pyllit, e pret rrugën “Ferid Bajram” dhe del në rrugën “Kroacia” deri në udhëkryqin me bulevardin “Hristijan Todorovski – Karposh”, vazhdon në veri përgjatë kufijve të jashtëm të KK Butel, KK Radishan, KK Luboten, KK Lubancë dhe përsëri lëviz përgjatë kufijve të jashtëm të KK Radishan dhe KK Butel deri te pikëtakimi i tre kufijve të komunave Butel, Shuto Orizarë dhe Çuçer-Sandevë.

Kufiri i komunës Gazi Babë fillon prej pikëtakimit të tre kufijve të komunave Butel, Gazi Babë dhe Çair nga paragrafi 2 i këtij neni, dhe lëviz përgjatë kufirit perëndimor të Park-pyllit “Gazi Babë”, kalon nën kompleksin e Fakultetit Matematikor-Natyror deri te udhëkryqi në bulevardin “Nikolla Karev” dhe rrugën “Bellasica” (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Gazi Babë, Çair dhe Qendër), kthen përgjatë rrugës “Bellasica” deri te ura e vijës hekurudhore në lumin Vardar (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Gazi Babë, Qendër dhe Aerodrom), vazhdon përgjatë rrjedhës së lumit Vardar, dhe përgjatë kufijve të jashtëm të KK Idrizovë, KK Jurumleri, KK Trubarevë, KK Inxhikovë, KK Singjeliq, KK Stajkovc, KK Straçincë, KK Creshevë, KK Bullaçan dhe KK Rashtak, vazhdon përgjatë kufirit me komunën Butel nga paragrafi 2 i këtij neni, deri te pikëtakimi i tre kufijve të komunave Gazi Babë, Butel dhe Çair.

Kufiri i komunës Gjorçe Petrov fillon prej udhëkryqit në autostradën Shkup – Tetovë (para urës mbi lumin Vardar), dhe lëviz në drejtim të rrjedhës përgjatë lumit Vardar deri te ura e rrugës së projektuar “Ciborovski” (“1249”), kthen përgjatë rrugës “Ciborovski” deri te udhëkryqi me rrugën “Gjorçe Petrov”, kthen në lindje përgjatë rrugës “Proleterska” (“1462”) deri te udhëkryqi me rrugën e projektuar “Aco Shopov” dhe përgjatë saj del në lumin Lepenc, kthen në drejtim të kundërt të rrjedhës së lumit Lepenc dhe vazhdon përgjatë kufijve të jashtëm të komunave të kadastrës KK Novo Sellë, KK Vollkovë, KK Orman, KK Nikishtan, KK Graçan, KK Kuçkovë dhe KK Orizarë deri tek udhëkryqi në autostradën Shkup – Tetovë (para urës mbi lumin Vardar).

Kufiri i komunës Karposh fillon prej urës së hekurt mbi lumin Lepenc, dhe lëviz përgjatë kufirit me komunën Gjorçe Petrovi, nga paragrafi 4 i këtij neni, deri në lokalitetin Llaka në lumin Vardar, vazhdon përgjatë kufijve të jashtëm të komunave kadastrale KK Nerez i Epërm, KK Vodno e Epërme, përkatësisht përgjatë vijës së malit Vodno deri në lokalitetin Teferiç (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Karposh, Kisella Vodë dhe Sopsishte), kthen në veri-perëndim deri mbi Institutin për inxhinierinë e tërmeteve dhe seizmologjinë e tërmeteve – IITST (pikëtakimi i tre

kufijve të komunave Karposh, Kisella Vodë dhe Qendër), vazhdon përgjatë qarkores së projektuar jugore të Qytetit të Shkupit deri te rruga “550”, kthen përgjatë saj deri te udhëkryqi me rrugën “Kozle”, shkon përgjatë rrugës “Kozle” deri tek udhëkryqi me rrugën e projektuar e cila kalon ndërmjet lagjeve Kozle dhe Kapishtec dhe del në udhëkryqin e rrugëve “Ivo Lolla Ribar” dhe “e Ruzveltit”, vazhdon përgjatë rrugës “së Ruzveltit” e pret bulevardin “Aradhat Partizane” dhe rrugën “e Ilindenit”, vazhdon përgjatë rrugës së këmbësorëve ndërmjet Kopshtit zoologjik dhe pjesës së parë të Parkut të qytetit, kalon nëpër urën për këmbësorë mbi lumin Vardar kthen në drejtim të kundërt të rrjedhës së ujit përgjatë lumit Vardar, del në bulevardin “Nikolla Karev”, kthen në lindje përgjatë bulevardit “Nikolla Karev” deri në hyrjen e kazermës “Ilinden” (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Karposh, Qendër dhe Çair), vazhdon përgjatë gardhit lindor të kazermës “Ilinden” mandej përgjatë rrugës së re të planifikuar me Planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit të Shkupit që çon deri te udhëkryqi i rrugëve “Brigada e Dytë Maqedonase” dhe “Brigada Maqedono-Kosovare” deri në rrugën magjistrale Shkup-Bllacë, vazhdon përgjatë kufijve të jashtëm të KK Zllokuqan dhe KK Bardovcë deri te lumi Lepenc (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Karposh, Gjorçe Petrov dhe Çuçer Sandevë) dhe përgjatë lumit Lepenc deri te ura e vijës hekurudhore. Kufiri i komunës Kisella Vodë fillon prej mbikalimit në vijën hekurudhore dhe rrugën “Brigada e Tretë Sulmuese Maqedonase” (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Kisella Vodë, Aerodrom dhe Qendër), dhe lëviz përgjatë trasesë së vjetër të vijës hekurudhore deri te mbikalimi në bulevardin “Koço Racin”, lëviz përgjatë rrugës “së Bihaqit”, rrugës “Cërniçe” (“437”) dhe rrugës “346” dhe del mbi Institutin për inxhinierinë e tërmeteve dhe seizmologjinë e tërmeteve - IITST, përkatësisht në pikëtakimin e tre kufijve të komunave Qendër, Karposh dhe Kisella Vodë, vazhdon përgjatë kufirit të Park-pyllit “Vodno” deri në lokalitetin Teferiç, vazhdon përgjatë kufirit të kadastrës të KK Sopishte, vazhdon përgjatë kufirit të jashtëm të KK Usje dhe KK Draçevë deri te stacioni hekurudhor Draçevë, kthen në veri-perëndim përgjatë vijës hekurudhore Shkup-Veles, si kufi me komunën Aerodrom deri te mbikalimi në rrugën “Brigada e Tretë Sulmuese Maqedonase” (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Kisella Vodë, Aerodrom dhe Qendër).

Kufiri i komunës Saraj fillon prej udhëkryqit në autostradën Shkup-Tetovë (para urës mbi lumin Vardar), dhe lëviz përgjatë kufijve të jashtëm të KK Kondovë, KK Svillare e Poshtme, KK Svillare e Epërme, KK Xeherorja Radushë, KK Dvorcë, KK Radushë, KK Kopanicë, KK Bojanë, KK Llaskarcë, KK Paniçar, KK Raovec, KK Çajlanë, KK Matkë, KK Shishevë, KK Gërçec dhe KK Krushopek deri te lumi Vardar (lokaliteti Llaka) dhe në drejtim të kundërt të rrjedhës së lumit Vardar deri tek udhëkryqi në autostradën Shkup-Tetovë (para urës mbi lumin Vardar). Kufiri i komunës Qendër fillon prej udhëkryqit të rrugës “Ivo Lolla Ribar” me rrugën “e Ruzveltit”, dhe lëviz përgjatë kufirit me komunën Karposh nga paragrafi 5 i këtij neni, deri te bulevardi “Nikolla Karev” dhe përgjatë tij në lindje deri te udhëkryqi me rrugën “Sllavej Pllanina”, vazhdon përgjatë rrugës “Sllavej Pllanina” del në rrugën “Samovilla”, kthen para kompleksit memorial “Shën Spas” përgjatë rrugës “Lazar Tanev”, vazhdon përgjatë rrugës “Pogradec” deri te mbikalimi në bulevardin “Goce Dellçev”, kthen majtas përgjatë bulevardit “Goce Dellçev” deri tek udhëkryqi me bulevardin “Kërste Misirkov”, kthen në veri përgjatë bulevardit “Kërste Misirkov” deri në hyrjen e Univerzitetit “Shën Cirili dhe Metodi”, vazhdon përgjatë gardhit verior të Univerzitetit “Shën Cirili dhe Metodi” deri te bulevardi “Nikolla Karev”, kthen në lindje përgjatë bulevardit “Nikolla Karev” deri te udhëkryqi me rrugën “Bellasica”, kthen në jug përgjatë rrugës “Bellasica” dhe del në lumin Vardar në pikëtakimin e tre kufijve të komunave Qendër, Gazi Babë dhe Aerodrom, dhe përgjatë kufirit me komunat Aerodrom dhe Kisella Vodë nga paragrafët 1 dhe 6 të këtij neni, deri tek udhëkryqi i rrugëve “Ivo Lolla Ribar” dhe “e Ruzveltit”. Kufiri i komunës Çair fillon prej bulevardit “Nikolla Karev” te hyrja e kazermës “Ilinden” dhe lëviz përgjatë kufirit me komunën Qendër nga paragrafi 8 i këtij neni, deri te udhëkryqi në bulevardin “Nikolla Karev” dhe rrugën “Bellasica” (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Çair, Qendër dhe Gazi Babë), vazhdon përgjatë kufirit me komunën Gazi Babë nga paragrafi 3 i këtij neni, deri te Qendra për deratizim (pikëtakimi i tre kufijve të komunave Çair, Gazi Babë dhe Butel), vazhdon përgjatë kufirit me

komunën Butel nga paragrafi 2 i këtij neni, deri te pikëtakimi i tre kufijve të kumunave Çair, Butel dhe Karposh, vazhdon përgjatë gardhit lindor të kazermës “Ilinden” deri tek udhëkryqi para hyrjes së kazermës “Ilinden”.

Kufiri i komunës Shuto Orizarë fillon prej pikëtakimit të tre kufijve të komunave Butel, Shuto Orizarë dhe Çuçer Sandevë dhe lëviz përgjatë kufirit me komunën Butel nga paragrafi 2 i këtij neni, deri në rrugën lokale për në fshatin Vizbeg, kthen përgjatë rrugës lokale për në fshatin Vizbeg, vazhdon përgjatë kufirit të jashtëm të KK Orizarë e Epërme deri te pikëtakimi i tre kufijve të komunave Butel, Shuto Orizarë dhe Çuçer Sandevë.

Neni 9

Në Qytetin e Shkupit, kompetencat në sferat e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë i kryejnë organet e Qytetit të Shkupit dhe organet e komunave në Qytetin e Shkupit.

Punët me rëndësi lokale të cilat funksionalisht janë të pandara dhe njëlloj të rëndësishme për tërë rajonin e Qytetit të Shkupit, i kryejnë organet e Qytetit të Shkupit.

Punët me rëndësi lokale të cilat sipas karakterit të tyre në mënyrë funksionale janë të ndashme dhe janë të rëndësishme për komunat e Qytetit të Shkupit, i kryejnë organet e komunave në Qytetin e Shkupit.

III. KOMPETENCAT E QYTETIT TË SHKUPIT DHE KOMUNAVE NË QYTETIN E SHKUPIT

a) Kompetencat e Qytetit të Shkupit

Neni 10

Kompetencat, përkatësisht punët me karakter publik me rëndësi lokale për Qytetin e Shkupit janë:

1. Planifikimi dhe rregullimi i hapësirës

- miratimi i planit hapësinor të Qytetit të Shkupit;
- miratimi i planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit;
- dhënia e mendimit për propozimin e planeve urbanistike të hollësishme, projekteve urbanistike dhe planeve urbanistike për vendbanime që i miratojnë komunat në Qytetin e Shkupit ;
- rregullimi i truallit ndërtimor;
- përcaktimi i standardeve dhe dhënia e pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme, mobilieve dhe pajisjes urbane në rajonin e Qytetit të Shkupit.

2. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës;

- mbrojtja, ndërmarrja e masave dhe parandalimi nga ndotja e ujit, ajrit, truallit, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurma dhe rrezatimit jojonizues në rajonin e Qytetit të Shkupit.

3. Zhvillimi ekonomik lokal

- planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal i Qytetit të Shkupit;
- përcaktimi i prioriteteve zhvillimore dhe strukturore në nivel të Qytetit të Shkupit;
- udhëheqja e politikës lokale ekonomike në nivel të Qytetit të Shkupit;
- përcaktimi i strategjisë dhe dhënia e përkrahjes

zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë;

- zhvillimi dhe nxitja e turizmit alternativ dhe kulturor;
- përmirësimi i kushteve për qëndrimin e turistëve në Qytetin e Shkupit dhe informimi turistik propagandistik.

4. Veprimtaritë komunale

- ndërtimi, shfrytëzimi, mbrojtja dhe mirëmbajtja e rrugëve magjistrale dhe rrugëve për tubime dhe objekteve tjera të infrastrukturës;

- kategorizimi dhe emërtimi i lagjeve të qytetit, rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës;

- furnizimi me ujë për pije nga sistemi unik për furnizim me ujë i Qytetit të Shkupit;

- mbartja dhe spastrimi i ujërave të zeza;

- mbartja dhe lëshimi i ujërave atmosferike; përpunimi dhe dërgimi i ujit teknologjik;

- ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët magjistrale dhe në rrugët për tubime në rajonin e Qytetit të Shkupit.

- grumbullimi dhe transportimi i hedhurinave komunale dhe hedhurinave tjera të parrezikshme;

- mirëmbajtja e deponive për hedhurina komunale dhe hedhurinave tjera të parrezikshme;

- rregullimi dhe organizimi i transportit urban dhe ndërurban të pasagjerëve;

- mirëmbajtja e pastërtisë publike në sipërfaqet e komunikacionit publik;

- mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve të qytetit, parqeve-pyje në rajonin e Qytetit të Shkupit, zonave me ujë dhe atyre rekreative-sportive, të përcaktuara me planin e përgjithshëm urbanistik dhe rajone tjera të mbrojtura në përputhje me ligjin; mirëmbajtja e gjelbërimit në rrugët magjistrale dhe në rrugët për tubime;

- ndërtimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i vendparkimeve publike të rëndësishme për Qytetin e Shkupit, të përcaktuara me planin urbanistik;

- vendosja, ndërrimi, largimi dhe mirëmbajtja e shenjave të komunikacionit dhe pajisjes për mbrojtje në rrugët lokale;

- përcaktimi i kushteve dhe regjimit të komunikacionit në rajonin e Qytetit të Shkupit;

- mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve

dhe dhënia e shërbimeve të varrimit në varrezat e qytetit, të përcaktuara me planin urbanistik;

- furnizimi me gaz natyror dhe energji për ngrohje;

- ndërtimi, udhëheqja, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i sistemit unik gjeografiko-informativ i Qytetit të Shkupit;

- rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve në pjesët e urbanizuara;

- dezinfektim në rajonin e Qytetit të Shkupit;

- ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e tregjeve me shumicë dhe tregjeve për shitjen e automjeteve në rajonin e Qytetit të Shkupit;

eradikimi i kafshëve që bredhin ;

- përcaktimi i vendeve për varrimin e kafshëve të ngordhura dhe mirëmbajtja e tyre; stolisja e Qytetit të Shkupit.

5. Kultura

- përkrahje institucionale dhe financiare të institucioneve dhe projekteve të rëndësishme për Qytetin e Shkupit;

- kultivimi i folklorit, zakoneve, zejeve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore;

- organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të ndryshme specifike të krijimtarisë;

- shënimi i ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme për Qytetin e Shkupit;

6. Arsimi

- themelimi, financimi dhe pjesëmarrja me përfaqësues të vet në organet drejtuese në shkollat e mesme publike në rajonin e Qytetit të Shkupit, në përputhje me ligjin;
- emërimi i drejtorëve në shkollat e mesme publike dhe në konviktet e nxënësve, në përputhje me ligjin;
- organizimi i transportit, ushqimi dhe akomodimi i nxënësve në konviktet e nxënësve, në përputhje me ligjin;

7. Sporti

- sigurimi i kushteve për zhvillimin e sportit cilësor në Qytetin e Shkupit;
- organizimi, nxitja dhe ndihma e manifestimeve sportive dhe manifestimeve zbavitëse të rëndësishme për Qytetin e Shkupit ;
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive të rëndësishme për Qytetin e Shkupit.

8. Mbrojtja sociale dhe e fëmijëve

- realizimi i përkujdesit social për persona invalidë, fëmijë pa prindër dhe përkujdesje prindore, fëmijë me probleme edukativo-sociale, fëmijë me nevoja të posaçme, fëmijë nga familjet me një prind, fëmijë në rrugë, persona të rrezikuar nga rreziku social, persona të përfshirë me keqpërdorimin e drogës dhe alkoolit, ngritja e vetëdijes së popullatës, strehimi i personave me rrezik social;
- prona, administrimi, themelimi, financimi dhe mirëmbajtja e institucioneve publike – azile për pleq, në përputhje me ligjin;
- prona, administrimi, themelimi, financimi dhe mirëmbajtja e institucioneve publike – pushimore për fëmijë, në përputhje me ligjin;
- pjesëmarrje me përfaqësues të vet në organet drejtuese të institucioneve publike për fëmijë – kopshte për fëmijë, në rajonin e Qytetit të Shkupit, në përputhje me ligjin;

9. Mbrojtja shëndetësore

- pjesëmarrje në administrimin me rrjetin e institucioneve shëndetësore publike dhe objektet për mbrojtje shëndetësore primare të rëndësishme për Qytetin e Shkupit;
- ndërmarrje masash për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtje gjatë punës;
- edukimi shëndetësor;
- avancimi i shëndetit;
- aktivitete preventive;
- mbikëqyrje shëndetësore ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj sëmundjeve ngjitëse.
- ndihmë pacientëve me nevoja speciale.

10. Mbrojtja dhe shpëtimi

- bashkërenditja e aktiviteteve për mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shfaqura nga to;

11. Mbrojtja kundër zjarrit

- mbrojtja kundër zjarrit në Qytetin e Shkupit.

12. Mbikëqyrje

- mbikëqyrje mbi kryerjen e punëve në kompetencë të Qytetit të Shkupit.

Mendimin nga paragrafi 1, pika 1, alineja 3 e këtij neni, Qyteti i Shkupit e jep më së voni brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimplanit, ndërkaq në qoftë se brenda këtij afati i njëjti nuk dorëzohet, do të konsiderohet se është dhënë mendim pozitiv.

Kompetenca nga paragrafi 1, pika 4, alineja 15 e këtij neni, realizohet në pajtim me organin e administratës kompetente shtetërore për punët e komunikacionit.

Organet e Qytetit të Shkupit mund të kryejnë edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 11

Qyteti i Shkupit gjatë kryerjes së punëve nga kompetenca e vet, miraton dhe siguron zbatimin e rregullores unike, përkujdeset për nivel të njëjtë shërbimesh dhe arritshmëri të barabartë te qytetarët, me aplikimin e standardeve të njëjta.

Neni 12

Qyteti i Shkupit, në kuadër të ligjit, në përputhje me parimin e supsidiaritetit, ka të drejtë që në rajonin e Qytetit të Shkupit, t'i kryejë punët me interes publik të rëndësishme për Qytetin e Shkupit, të cilat nuk janë përjashtuar nga kompetenca e tij ose nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror.

Neni 13

Qyteti i Shkupit, për kryerjen e punëve publike me rëndësi lokale në kuadër të kompetencave të veta, mund të themelojë shërbime publike, në përputhje me ligjin.

Neni 14

Qyteti i Shkupit i kryen punët që dalin nga karakteri i Qytetit të Shkupit, si kryeqyteti Republikës së Maqedonisë.

Qytetit të Shkupit, si kryeqytet i Republikës së Maqedonisë, Republika mund t'i japë të drejta të caktuara ose t'ia besojë kryerjen e punëve të caktuara.

b) Kompetencat e komunave në Qytetin e Shkupit

Neni 15

Kompetencat, përkatësisht punët me interes publik të rëndësishme lokale të komunave në qytetin e Shkupit janë:

1. Planifikimi dhe rregullimi i hapësirës

- ngritja e iniciativave për miratim, ndryshim dhe plotësim të planit hapësinor të Qytetit të Shkupit dhe planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit;

- dhënia e mendimit për draftet e planit hapësinor të Qytetit të Shkupit dhe planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit;

- miratimi i planeve të hollësishme urbanistike, projekteve urbanistike dhe planeve urbanistike për vendbanimet në komunë;

- realizimi i planeve dhe projekteve urbanistike dhe lëshimi i dokumentacionit për ndërtimin e objekteve me rëndësi lokale (kushtet për ndërtim, pëlqimi urbanistik, leje për ndërtim);
- lëshimi i lejeve për vendosjen e objekteve të përkohshme, mobiljeve dhe pajisjes urbane;
- rregullimi i truallit ndërtimor në pjesën e pajisjes së truallit ndërtimor me objekte dhe instalime nga infrastruktura sekondare.

2. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës;

- ngritja e iniciativave dhe ndërmarrja e masave për mbrojtje dhe parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit, truallit, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurma dhe nga rrezatimi jojonizues.

3. Zhvillimi ekonomik lokal

- planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal i komunës;

përcaktimi i strukturave zhvillimore me prioritet për komunën;

- përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë në komunë.

4. Veprimtari komunale

- ndërtimi, mirëmbajtja, rikonstruksioni dhe mbrojtja e rrugëve ndihmëse dhe rrugëve të banimit dhe objekteve tjera të infrastrukturës;
- mirëmbajtja e pastërtisë publike në rrugët ndihmëse dhe në rrugët e banimit;
- organizimi, grumbullimi dhe transportimi i hedhurinave komunale dhe hedhurinave tjera të parrezikshme;
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët e banimit dhe në rrugët ndihmëse në rajonin e Qytetit të Shkupit;
- mirëmbajtja e varreve dhe varrezave dhe dhënia e shrbimeve për varrim në varrezat e qytetit të përcaktuara me planin urbanistik;
- ndërtimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i vendparkimeve publike të rëndësishme për komunën të përcaktuara me planin urbanistik;
- mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i gjelbërimit në rrugët ndihmëse dhe në rrugët banesore;
- largimi i automjeteve të paregjistruara me motor dhe automjeteve tjera nga sipërfaqet publike;
- mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i tregjeve publike;
- dezinfektimi dhe deratizimi;
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e nyjeve sanitare publike.

5. Kultura

- përkrahja institucionale dhe financiare e institucioneve kulturore dhe projekteve me rëndësi për komunën;
- kultivimi i folklorit, traditës, zejeve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore;
- organizimi i manifestimeve kulturore, nxitja e formave të ndryshme specifike të krijimtarisë;
- shënimi i ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishëm për komunën;

6. Arsimi

- themelimi, financimi dhe pjesëmarrja në administrimin me shkollat fillore në rajonin e tij, në përputhje me ligjin;

- emërimi i drejtorëve në shkollat fillore, në përputhje me ligjin;
- transporti dhe ushqimi i nxënësve në shkollat në kompetencë të saj, në përputhje me ligjin;

7. Mbrojtja sociale dhe e fëmijëve

- prona, administrimi, themelimi, financimi dhe mirëmbajtja e institucioneve publike për fëmijë – kopshte për fëmijë, në përputhje me ligjin;
- ndërmarrje masash nga sfera e mbrojtjes sociale në përputhje me ligjin;

8. Mbrojtja shëndetësore

- ndërmarrje masash për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës;
- edukimi shëndetësor;
- avancimi i shëndetit;
- aktivitete preventive;
- mbikëqyrje shëndetësore ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj sëmundjeve ngjitëse.
- ndihmë pacientëve me nevoja speciale.

9. Mbrojtja dhe shpëtimi

- mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve dhe i të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës dhe nga fatkeqësitë elementare dhe nga fatkeqësi tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga të njëjtat.

10. Mbikëqyrja

- mbikëqyrje mbi kryerejen e punëve në kompetencë të komunës.

Planet dhe projektet nga paragrafi 1, pika 1, alineja 3 e këtij neni, komuna i miraton sipas mendimit pozitiv paraprakisht të marrë nga Qyteti i Shkupit dhe pëlqimit të organit të administratës kompetente shtetërore për punët e rregullimit të hapësirës.

Punët nga paragrafi 1, pika 1, alineja 5 e këtij neni, kryhen në pajtim me standardet e përcaktuara, dhe sipas pëlqimit të marrë paraprakisht nga Qyteti i Shkupit.

Punët nga paragrafi 1, pika 4 alineja 3 e këtij neni, kryhen në pajtim me Qytetin e Shkupit. Punët nga paragrafi 1, pika 9 alineja 3 e këtij neni, kryhen në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit.

Neni 16

Qyteti i Shkupit është i obliguar që për të gjitha iniciativat e ngritura dhe propozimet e dhëna nga komunat në Qytetin e Shkupit të marrë qëndrim dhe për këtë ta njoftojë komunën në Qytetin e Shkupit.

Neni 17

Komunat në Qytetin e Shkupit, në kuadër të ligjit, në përputhje me parimin e supsidiaritetit, kanë të drejtë që në rajonin e komunës t'i ushtrorjnë punët me interes publik të rëndësishme për komunën, të cilat nuk janë përjashtuar nga kompetenca e tyre, nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror ose në kompetencë të organeve të Qytetit të Shkupit.

Neni 18

Komunat në Qytetin e Shkupit, për kryerjen e punëve publike me rëndësi lokale në kuadër të kompetencave të veta, mund të themelojnë shërbime publike, në përputhje me ligjin.

IV. ORGANET E QYTETIT TË SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E SHKUPIT

Neni 19

Organe të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit janë: Këshilli dhe Kryetari i komunës.

Neni 20

Këshillin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë 45 anëtarë. Numri i anëtarëve të këshillave të komunave në Qytetin e Shkupit përcaktohet në pajtim me ligjin.

Neni 21

Të drejtë të zgjedhen për anëtarë të Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetar komune të Qytetit të Shkupit kanë banorët e qytetit të Shkupit.

Të drejtë të zgjedhen për anëtarë të Këshillit të komunës së Qytetit të Shkupit dhe për kryetar komune në komunën e Qytetit të Shkupit, kanë banorët e qytetit të Shkupit me vendbanim të përhershëm në rajonin e komunës ku bëhet zgjedhja.

V. FINANCIMI I QYTETIT TË SHKUPIT DHE I KOMUNAVE NË QYTETIN E SHKUPIT

Neni 22

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, financohen nga burimet e të hyrave vetjake, të hyrat nga tatimet, të hyrat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe buxhetet e fondeve, të hyrat nga ngarkimet me borxh në pajtim me ligjin dhe nga të hyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 23

Për shkak të sigurimit të kushteve të barabarta për financimin e komunave në qytetin e Shkupit dhe për kënaqjen e nevojave të përbashkëta të qytetarëve në qytetin e Shkupit, formohet Fondi i përbashkët i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejme: Fondi i përbashkët).

Fondi i përbashkët formohet nga mjetet e tatimit mbi të ardhurat personale, taksat komunale për firma dhe taksat komunale për shfrytëzimin e rrugëve me automjete, mjete transporti dhe mjete me rimorkio dhe mjete tjera, në pajtim me ligjin.

Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, të hyrat nga Fondi i përbashkët i realizojnë në pajtim me metodologjinë për shpërndarje të mjeteve nga Fondi i përbashkët. Metodologjinë nga paragrafi 3 e këtij neni e miraton ministri i Financave.

a) Burime të të hyrave

Neni 24

Burime vetjake të të hyrave në Qytetin e Shkupit dhe në komunat në qytetin e Shkupit, janë:

- tatimet lokale (tatimi mbi pronën; tatimi mbi qarkullimin e patundshmërive; tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën; tatime të tjera lokale të përcaktuara me ligj);
- taksat lokale (taksat komunale, taksat administrative dhe taksa të tjera lokale të përcaktuara me ligj);
- kompensimet lokale (kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore; kompensim për veprimtari komunale; kompensim për plane hapësinore urbanistike; kompensime të tjera lokale të përcaktuara me ligj);
- të hyrat nga pronësia (të hyra nga dhënia me qira e pronës; të hyra nga kamatat; të hyra nga shitja e pronës);
- të hyrat nga vetëkontributi;
- të hyrat nga ndëshkimet e përcaktuara me ligj;
- të hyrat nga donacionet;
- të hyra të tjera të përcaktuara me ligj.

1) Të hyrat nga tatimet lokale

Neni 25

Të hyrat nga tatimet lokale, janë të hyra të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit dhe shpërndahen ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit.

Neni 26

Të hyrat e realizuara në bazë të shkallës më të ulët tatimore për tatimin mbi pronën, tatimin mbi trashëgiminë dhe dhuratën dhe tatimin mbi qarkullim të patundshmërive, të përcaktuar me ligj, shpërndahet në përpjesëtim 50% për Qytetin e Shkupit dhe 50% për komunën përkatëse në qytetin e Shkupit.

Neni 27

Qyteti i Shkupit mund të përcaktojë shkallë më të lartë të tatimit mbi pronën nga shkalla më e ulët e tatimit mbi pronën të përcaktuar me ligj, më së shumti deri në 0.05%.

Komunat në qytetin e Shkupit mund të përcaktojnë shkallë më të lartë të tatimit mbi pronën nga shkalla më e ulët e tatimit mbi pronë të përcaktuar me ligj, më së shumti deri në 0.05%.

Të hyrat e realizuara në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat e realizuara në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, janë të hyra të komunës në qytetin e Shkupit.

Neni 28

Qyteti i Shkupit mund të përcaktojë shkallë më të lartë të tatimit mbi qarkullimin e patundshmërive nga shkalla më e ulët e tatimit mbi qarkullim të patundshmërive, të përcaktuar me ligj, më së shumti deri në 1%.

Komunat në qytetin e Shkupit mund të përcaktojnë shkallë më të lartë të tatimit mbi qarkullimin e patundshmërive nga shkalla më e ulët e tatimit mbi qarkullim të patundshmërive, të përcaktuar me ligj, më së shumti deri në 1%.

Të hyrat e realizuara në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat e realizuara në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, janë të hyra të komunës në qytetin e Shkupit.

Neni 29

Qyteti i Shkupit e përcakton shkallën e tatimit mbi trashëgiminë dhe dhuratën, në suaza të përcaktuara me ligj dhe i grumbullon mjetet si të hyra të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, shpërndahen në përpjesëtim 50% për Qytetin e Shkupit dhe 50% edhe për komunën përkatëse në qytetin e Shkupit.

2.) Të hyrat nga tatimet tjera

Neni 30

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, realizojnë të hyra nga tatimi mbi të ardhurat personale, në pajtim me ligjin.

Të hyrat nga paragrafi 1 i këtij neni janë të hyra të Fondit të përbashkët.

Neni 31

Shpërndarja e të hyrave të Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit nga tatimet tjera të përcaktuara me ligj, përcaktohet me ligjet e posaçme.

3.) Të hyrat nga taksat komunale

Neni 32

Taksat komunale nga të cilat Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit realizojnë të hyra, janë:

- taksat për firmë, përkatësisht emërtimi i lokalit afarist;
- taksat për shfrytëzimin e rrugëve me automjete, automjete transporti, autobusë, automjete të posaçme dhe motoçikleta;
- taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve si kampe për ngritjen e çadrave dhe përdorim tjetër të ngjashëm të perkohshëm;
- taksat për shfrytëzimin e muzikës në lokalet publike;
- taksat për shfrytëzimin e hapësirës para lokalit afarist për kryerjen e veprimtarisë;
- taksat për vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike;
- taksat për vendosjen e vitrinave për ekspozimin e mallrave jashtë nga ndërtesat afariste;
- taksat për shfrytëzimin e shesheve dhe hapësirës tjetër në qytetet dhe vendet tjera të banuara, me qëllim të ekspozimit të sendeve, paraqitjes së ekspozitave dhe shfaqjeve tjera argëtuese për kryerjen veprimtarisë;
- taksat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik;
- të hyra të tjera komunale të përcaktuara me ligj

Neni 33

Të hyrat nga taksat komunale, si të hyra të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit, shpërndahen ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit.

Neni 34

Qyteti i Shkupit e përcakton taksën për firmën përkatësisht emërtimin e lokaleve afariste dhe taksën për shfrytëzimin e rrugëve me automjete, automjete transporti, autobusë, automjete të posaçme dhe motoçikleta, në suaza të përcaktuara me ligj.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, shpërndahen në përpjesëtim 50% për Qytetin e Shkupit dhe 50% në Fondin e përbashkët.

Neni 35

Qyteti i Shkupit e përcakton taksën për shfrytëzimin e sipërfaqeve si kampe për ngritjen e çadrave dhe përdorim tjetër të ngjashëm të përkohshëm dhe taksën për shfrytëzimin e muzikës në lokalet publike, në suaza të përcaktuara me ligj.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, i grumbullon Qyteti i Shkupit.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, shpërndahen në përpjesëtim 70% për Qytetin e Shkupit dhe 30% për komunat në qytetin e Shkupit.

Neni 36

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, në suazat e përcaktuara me ligj, përcaktojnë:

- taksa për shfrytëzimin e hapësirës para lokalit afarist për kryerjen e veprimtarisë;
- taksa për vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike;
- taksa për vendosjen e vitrinave për ekspozimin e mallrave jashtë ndërtesave afariste;
- taksa për shfrytëzimin e shesheve dhe hapësirës tjetër në qytetet dhe vendbanimet tjera, me qëllim të ekspozimit të sendeve, paraqitjes së ekspozitave dhe shfaqjeve tjera argëtuese për kryerjen e veprimtarisë;

Taksat nga paragrafi 1 i këtij neni grumbullohen nga Qyteti i Shkupit ose nga komunat në qytetin e Shkupit, varësisht nga ajo se kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e hapësirës publike që shfrytëzohet.

Neni 37

Taksa komunale për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, përcaktohet dhe grumbullohet në pajtim me ligjin.

4.) Të hyrat nga taksat administrative dhe taksat tjera lokale

Neni 38

Të hyrat nga taksat administrative dhe taksat tjera lokale të përcaktuara me ligj, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e punëve në kompetencë të Qytetit të Shkupit, janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat nga taksat administrative dhe taksat tjera lokale të përcaktuara me ligj, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e punëve në kompetencë të komunës në qytetin e Shkupit, janë të hyra të komunës.

5.) Të hyrat nga kompensimet

Neni 39

Të hyrat nga kompensimet lokale, si të hyra të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit, shpërndahen ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit.

Neni 40

Të hyrat nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore shpërndahen në përpjesëtim 60% për Qytetin e Shkupit dhe 40% për komunën në qytetin e Shkupit në të cilën rregullohet toka ndërtimore.

Të hyrat nga kompensimet e veprimtarisë komunale, kompensimet për planet hapësinore dhe urbanistike dhe nga kompensime tjera të përcaktuara me ligj të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e punëve në kompetencë të Qytetit të Shkupit, janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat nga kompensimet për veprimtari komunale, kompensimet për planet hapësinore dhe urbanistike dhe kompensime të tjera të përcaktuara me ligj, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e punëve në kompetencë të komunës, janë të hyra të komunës.

6.) Të hyrat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e fondeve dhe nga të hyra të tjera

Neni 41

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga buxhetet e fondeve pranojnë:

- dotacione të destinuara;
- bllok dotacione;
- dotacione kapitale;
- dotacione për kompetenca të deleguara.

Neni 42

Të hyrat nga pronësia e Qytetit të Shkupit janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat nga pronësia e komunës së Qytetit të Shkupit janë të hyra të komunës.

Neni 43

Të hyrat nga vetëkontributi që eka shpallur Qyteti i Shkupit janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat nga vetëkontributi që e ka shpallur komuna në qytetin e Shkupit janë të hyra të komunës.

Neni 44

Të hyrat nga ndëshkimet e përcaktuara me ligj, janë të hyra të Qytetit të Shkupit ose të komunës në qytetin e Shkupit, në pajtim me dispozitat e ligjeve të posaçme.

Neni 45

Të hyrat e realizuara nga donacione për Qytetin e Shkupit, janë të hyra të Qytetit të Shkupit.

Të hyrat e realizuara nga donacione për komunat në qytetin e Shkupit, janë të hyra të komunës.

Me të hyrat nga donacionet, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit disponojnë pavarësisht.

Neni 46

Të hyrat të tjera të përcaktuara me ligj, janë të hyra të Qytetit të Shkupit dhe të hyra të komunave në qytetin e Shkupit, në pajtim me dispozitat e ligjeve të posaçme.

7.) Ngarkimi me borxh

Neni 47

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, mund të ngarkohen me borxh në vend dhe jashtë vendit, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, në pajtim me ligjin mund të japin garanci dhe të ndërmarrin obligime të cilat dalin nga huazimet afatgjate të ndërmarrjeve publike të cilat ato i kanë themeluar.

b) Arkëtimi i të hyrave

Neni 48

Punët e përcaktimit dhe arkëtitimit të tatimeve lokale të Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, i kryen administrata tatimore e Qytetit të Shkupit.

Punët e përcaktimit dhe arkëtitimit të taksave dhe kompensimeve të cilat janë të hyra të Qytetit të Shkupit, i kryen administrata tatimore e Qytetit të Shkupit.

Punët e përcaktimit dhe arkëtitimit të taksave dhe kompensimeve të cilat janë të hyra të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit, i kryen administrata tatimore e Qytetit të Shkupit.

Punët e përcaktimit dhe arkëtitimit të taksave dhe kompensimeve të cilat janë të hyra të komunave në qytetin e Shkupit, i kryen administrata tatimore e komunave.

Punët nga paragrafi 4 i këtij neni, komunat në qytetin e Shkupit, mund t'ia besojnë Qytetit të Shkupit.

Tatimet, taksat dhe kompensimet të cilat janë arkëtuar nga administrata tatimore e Qytetit të Shkupit, e janë të hyra të komunave në qytetin e Shkupit, shpërndahen në muaj.

Neni 49

Qyteti i Shkupit, u dërgon komunave në Qytetin e Shkupit raporte kuartale për arkëtimin dhe shpërndarjen e të hyrave.

VI. PËRDORIMI I GJUHËVE TË BASHKËSIVE NË QYTETIN E SHKUPIT DHE NË KOMUNAT NË QYTETIN E SHKUPIT

Neni 50

Në Qytetin e Shkupit gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Në Qytetin e Shkupit, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuhë zyrtare është edhe gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e banorëve të Qytetit të Shkupit.

Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% të banorëve të Qytetit të Shkupit, vendos Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Rregullat të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve dhe alfabeve në të cilat flasin më së paku 20% të banorëve të Qytetit të Shkupit, miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit të Qytetit të Shkupit, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit, të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë e banorëve në Qytetin e Shkupit.

Neni 51

Në komunat në Qytetin e Shkupit, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Në komunat në Qytetin e Shkupit, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuhë zyrtare është edhe gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% të banorëve të komunës.

Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeve në të cilat flasin më pak se 20% të banorëve në komunat në Qytetin e Shkupit, vendos Këshilli i komunës.

Rregullat të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve dhe alfabeve në të cilat flasin më pak se 20% të banorëve të komunës, miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të këshillit të komunës, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të këshillit të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë të banorëve në komunë.

VII. MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI I QYTETIT TË SHKUPIT DHE KOMUNAVE NË QYTETIN E SHKUPIT

Neni 52

Në kryerjen e punëve në kompetencën e tij, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit realizojnë bashkëpunim të ndërsjellë përmes:

- këmbimit të materialeve nga kompetenca e tyre, për shkak të informimit të ndërsjellë ose dhënies së pëlqimit;
- inicimit të akteve dhe masave për rregullimin e punëve me interes të përbashkët për Qytetin e Shkupit;
- ndërmarrjes së aksioneve dhe masave të përbashkëta për zgjidhjen dhe kryerjen e punëve në kompetencën e tyre;
- dhënies së ndihmës profesionale në zbatimin e ligjeve dhe rregullave tjera.

Neni 53

Për realizimin e bashkëpunimit të përbashkët të prefektit të Qytetit të Shkupit dhe kryetarëve të komunave në qytetin e Shkupit, themelohet Trupi koordinues i kryetarëve të komunave (në tekstin e mëtejme Trupi koordinues).

Trupin koordinues e përbëjnë prefekti i Qytetit të Shkupit dhe kryetarët e komunave në qytetin e Shkupit ose përfaqësues të autorizuar nga ta.

Me Trupin koordinues udhëheq prefekti i Qytetit të Shkupit.

Neni 54

Trupi koordinues:

- shqyrton dhe jep rekomendime për çështje me interes të përbashkët të Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe harmonik të Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit.
- i harmonizon strategjitë dhe planet të cilat ndikojnë në zhvillimin e qytetit si tërësi hapësinore dhe funksionale unike;

- detyrimisht i harmonizon qëndrimet që kanë të bëjnë me planet urbanistike detajike dhe të përgjithshme, planet për transportin publik, planet teknike infrastrukturore, administrimin dhe arkëtimin e të hyrave vetjake, nevojat për të hyra dhe të dala të qytetit dhe të komunave;
- nxjerr rregullore për punën e vet.

Neni 55

Trupi koordinues mban seancë së paku një herë në muaj.
Seancat i përgatit dhe organizon administrata e Qytetit të Shkupit.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 56

Në zgjedhjet e ardhshme lokale për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Qytetit të Shkupit, numri i anëtarëve të Këshillit të Qytetit të Shkupit do të përcaktohet në pajtim me nenin 20, paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 57

Seancën konstitutive të komunave të posathemeluara në Qytetin e Shkupit, do ta konvokojë kryetari i këshillit të përbërjes të mëparshme të komunës nga e cila ka dalë komuna e re.

Neni 58

Kushte hapësinore, materialo-teknike dhe mjete tjera për fillimin me punë të komunave të posathemeluara në Qytetin e Shkupit, do të sigurohen nga mjetet e të hyrave të realizuara mbi shumën e përcaktuar, në pajtim me Ligjin për kufizimin e të hyrave burimore për financimin e nevojave publike për vitin 2004.

Lartësinë, mënyrën dhe kushtet për shfrytëzimin e mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni, do t'i përcaktojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 59

Organet e komunës së posaformuar deri në sigurimin e kushteve për fillimin me punë, do të punojnë në lokalet e komunës nga e cila kanë dalë.

Punët administrative për komunën e posaformuar deri në nxjerrjen e aktit për organizim dhe sistematizim, do t'i kryejë administrata komunale e komunës nga e cila ka dalë komuna e posathemeluar.

Neni 60

Në afat prej 60 ditësh nga dita e konstituimit të këshillave të komunave të posathemeluara dhe komunat nga të cilat kanë dalë, do të bëhet bilanci ndarës i pronës së patundshme sipas vendpozitës përkatësisht përkatësisë së pronës në rajonin e komunës përkatëse.

Bilancin ndarës do ta zbatojë komisioni i formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë nga përfaqësues të komunave nga paragrafi 1 i këtij neni dhe përfaqësues i Qeverisë së Republikës të Maqedonisë.

Neni 61

Komunat në Qytetin e Shkupit nga të cilat kanë dalë komunat e posaformuara, janë të obliguara që dokumentacionin, evidencën dhe arkivin që ka të bëjë me punët në kompetencë të komunave të posaformuara, t'ua dorëzojnë në afat prej 30 ditësh nga dita e konstituimit të këshillave të komunave.

Neni 62

Lëndët dhe procedurat e filluara të cilat nuk kanë mbaruar ndërsa janë në kompetencë të komunave të posaformuara, do t'i ndërmarrin dhe do t'i përfundojnë komunat e posaformuara, në pajtim me ligjin.

Neni 63

Punësimi në komunën e posaformuar në pajtim me aktet për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, mund të bëhet pas dhënies paraprake të pëlqimit pozitiv nga Agjencia për nëpunës shtetërorë dhe mjeteve të siguruara në buxhetin e komunës së posaformuar.

Neni 64

Metodologjia nga neni 23, paragrafi 3 i këtij ligji do të nxirret në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 65

Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit do t'i nxjerrin ose harmonizojnë aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij ligji në afat prej 3 muajsh nga dita e konstituimit të këshillave të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit

Neni 66

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/96 dhe 53/2001).

Neni 67

Ky ligj hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet prej zgjedhjeve të ardhshme lokale.